

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                         |
|---------|-------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | John Legend paralajmëron albumin e ri "Muse"                            |
| ADRESA  | https://www.koha.net/showbiz/john-legend-paralajmëron-albumin-e-ri-muse |
| BURIMI  | koha.net                                                                |
| GJENDJA | online                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 13 shtator 2026, 18:52:09 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 21:30:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | c9c3d779b56ceea4afdb8fb804a578f7125e5b27fcc7bdc167edeb0331c89b72 |
| TEKSTI     | d45e33dda687b98c33c43f54ce1ec59147f8d6cda3427b2374c8f68bfa784110 |
| PAMJA      | 595c9779786450e4e6dade9ade57132ee075336bde3228ddb7e95a8cfcca8671 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 36624207e3b7f9ebf88d84a65d6312080c957ae65a0862e1b6a12012f47e1300                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/36624207e3b7f9ebf88d84a65d6312080c957ae65a0862e1b6a12012f47e1300

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

SHOWBIZ

## John Legend paralajmëron albumin e ri “Muse”



12 shtator 2026 23:30

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanal in tonë zyrtar në Viber

John Legend dhe Pharrell Williams realizuan një album në Paris vitin e kaluar për të cilin artisti, i cili gëzon statusin EGOT, thotë se është ndryshe nga çdo album tjetër i tij.

“Muse”, i cili do të publikohet më 23 tetor nga “Republic Records” — dhe që është shkruar e regjistruar në studion e Pharrellit në selinë qendrore të “Louis Vuitton”, ku ai është drejtor kreativ për koleksionet e meshkujve — e nxiti John Legend të largohej nga standardet klasike të përjetshme të pianos dhe të eksplorojë një “estetikë të James Bondit me ngjyrimet e errëta, por me një ritëm modern në thellësi”.

“Në këtë incizim dëgjon gjurmë të miat dhe gjurmë të tijat, por tingëllon si diçka e re për të dy ne. Kombinimi im me Pharrellin, në letër, mendoj se është një ide e mirë. Dhe rezultati del të jetë edhe më i mirë”, ka thënë artisti për albumin “Muse”, në një deklaratë për shtyp të publikuar të martën. “Mendoj se repertori im ka qenë gjithmonë shumë i larmishëm, por baladat e drejtuara nga pianoja kanë pasur më shumë sukses gjatë karrierës sime. Doja ta ndryshoja formulën dhe të bëja diçka të freskët dhe të re”, tregon Legend për projektin e ri të dyshes, i cili vjen me inspirime nga artistë si Nina Simone, Nat King Cole dhe Marvin Gaye.

“Daylight”, kënga e parë nga “Muse”, tashmë është publikuar në platformat muzikore. Legend e prezantoi paraprakisht këngën me një performancë nga Nashville, e cila u transmetua në kanal in CBS një natë më parë.

Një tjetër këngë nga albumi me titull “Pray for Ya”, shoqëroi sfilatën e “Louis Vuitton” për koleksionin e meshkujve vjeshtë/dimër 2026.

Edhe



Showbiz • 3 qer 2026

Ellie Goulding zbulon detaje për albumin e saj të gjashtë në studio

Pharrell ka prodhuar të gjithë albumin. Ai është gjithashtu bashkautor dhe artist mysafir në gjashtë këngë.

## Futboll.

Amir Rrahmani flet për “Sky Sports”

## Arbëri.

Aliu: Bashkëpunimi mes universiteteve të Kosovës dhe Shqipërisë, kthesa më e madhe në hapësirën shqiptare

## Arbëri.

Aliu: Kosova ka qenë shteti i dytë i shqiptarëve të Jugosllavisë

## Futboll.

Fitore e Rrahmanit me Napolin

## Futboll.

“Fundi” jo i lavdishëm i karrierës së suksesshme të Rrahmanit te Kosova

## Arbëri.

Ali Aliu në PIKË me Veton Surroin (II)

Titulli “Muse” është frymëzuar pjesërisht nga nëntë Muzat e mitologjisë së lashtë greke. Është gjithashtu emri i këngës kryesore të albumit, e cila përshkruan një “marrëdhënie të trazuar mes një burri dhe muzës së tij ... në sfondin romantik të Parisit”.

“Paraardhësit tanë janë muzat tona. Muzika ime ka qenë gjithmonë një mënyrë përmes së cilës unë kanalizoj paraardhësit, marr atë që ata na kanë dhënë dhe krijoj diçka të re. Kam incizuar disa këngë në këtë album që Pharrell i kishte shkruar tërësisht vetë, gjë që pothuajse nuk e bëj kurrë”, ka deklaruar tutje Legend.

Ai tregon se partneri i tij në albumin e ardhshëm e ka falënderuar për besimin dhe durimin gjatë gjithë procesit të tyre bashkëpunues.

Edhe



Showbiz • 2 qer 2026

Shaggy feston 30-vjetorin në muzikë me albumin e ri “Lottery”

“Ka shumë artistë që arrijnë në një pikë të karrierës së tyre ku nuk krijojnë më asgjë të re. Mund të vazhdojmë t’i performojmë vetëm hitet e kaluara dhe të qëndrojmë në zonën tonë të rehatisë. Por unë besoj se është e rëndësishme të vazhdoj ta dëshmoj veten. Doja që ky album të kishte atë ndjesinë e urgjencës, të ndihej si diçka që duhej patjetër të krijohet dhe që e meriton plotësisht vëmendjen e publikut tim”, ka përfunduar artisti.

Albumi “Muse” do të jetë në dispozicionin e adhuruesve nga 23 tetori.

#JOHN LEGEND

#ALBUM

#SHOWBIZ

## Artikuj të ngjashëm



Showbiz • 1 qer 2026

The Rolling Stones shtynjë planet për turne, Mick Jagger shpreson për rikthim sa më shpejt



Showbiz • 27 mar 2026

Paul McCartney paralajmëron publikimin e albumit të ri



Showbiz • 24 sht 2025

John Legend: Dashuria dhe mbështetja janë çelësi i martesës së lumtur

# KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejtë njësie që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Marketing

Politika e privatisësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatisësisë dhe cookies

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.